

NEWSLETTER No.2

“BUILDING COMMUNITIES OF KNOWLEDGE FOR COMPETITIVE MSE-S”

Priority Axis 1. Entrepreneurship & Innovation – Sp. Objective 1.3 Territories of Knowledge,
Project No. 1848, Subsidy Contract No BMP1/1.3/1848/2019,
Interreg V-B “Balkan – Mediterranean 2014 – 2020”

LANCIMI I PROJEKTIT

"Krijimi i një platforme me njohuritë e nevojshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në treg" me akronimin Skills4MSE, në kuadër të “Programit të Bashkëpunimit Ballkanik - Mesdhetar 2014 -2020”.

Më 27 Shtator 2019, Fondacioni ABC organizoi në Hotel Rogner, Tiranë, eventin për lancimin e Projektit.

Në këtë takim morën pjesë palë të interesuara si sipërmarrës të ndryshëm, të cilët kanë biznese të vogla, përfaqësues nga bashkitë e rretheve të ndryshme, përfaqësues të zyrave të punësimit, fermerë të vegjël, të rinj me ide dhe të interesuar në hapjen e një biznesi të vogël, etj.

Pjesëmarrësit në këtë takim patën mundësinë të njiheshin me detaje të projektit, objektivat e projektit, aktivitetet që do të kryhen në kuadër të tij, cilët mund të marrin pjesë në projekt dhe përfitimet e mundshme nga pjesëmarrja në të.

Prezantimi i Projektit u bë nga Prof. Asoc. Dr. Altin Muça, përfaqësues i Projektit.



Ndër të tjera, Z. Muça theksoi rëndësinë e zhvillimit të aftëive jo vetëm profesionale por edhe aftësive të tjera ndërpersonale në një mjedis ekonomik gjithnjë në ndryshim dhe në zhvillim.

Në një treg që ndryshon shumë shpejt dhe në mënyrë të vazhdueshme, informimi dhe trajnimi i sipërmarrësve, dhe jo vetëm, dhe orientimi i tyre për t'u përgatitur sa më mirë për integrimin dhe përshtatjen në këtë treg është një detyrë e rëndësishme, e cila do të ketë ndikimin e vet të drejtpërdrejtë në suksesin e biznesit dhe zhvillimin e ekonomisë.

Kjo është edhe një arsye pse në kuadër të projektit, veç trajnimit të sipërmarrësve, do të krijohet edhe një platform online për trajnimin e të gjithë të interesuarve.

Trajnimi i sipërmarrësve për rritjen e kapacitetit të tyre dhe pajisjen me aftësi të reja profesionale dhe ndërpersonale është element kyç, me qëllimin që ata të kuptojnë se integrimi dhe qëndrueshmëria në tregun e punës, e cila çon drejtpërdrejtë në rritjen e mirëqënies, realizohet jo vetëm nëpërmjet njohurive bazë të marrë në shkollë (të cilat kanë peshën e vetë në zhvillimin e një shoqërie moderne të bazuar në dije dhe kërkim të avancuar), por edhe nëpërmjet krijimit të një fuqie punëtore të bazuar në aftësi teknike profesionale dhe aftësitë e duhura ndërpersonale, duke mundësuar një përdorim eficient të sistemit të trajnimit dhe formimit profesional.

Zhvillimet në teknologji, zhvillimet dhe ndryshimet e tendencave të tregut, sjellin një mospërputhje midis aftësive ekzistuese dhe asaj se për çfarë kanë nevojë sipërmarrjet dhe menaxhimi efikas i tyre.

Roli që ka sipërmarrja mikro dhe e vogël në ekonominë shqiptare, si një motor i zhvillimit ekonomik

Gjatë këtij takimi, pjesëmarrësit u njohën gjithashtu edhe me rolin që ka sipërmarrja mikro dhe e vogël në ekonominë shqiptare, si një motor i zhvillimit ekonomik.

Ndër të tjera Dr. Robert Lukaj theksoi: “Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme u duhet kushtuar një rëndësi strategjike, sepse llogariten si promotor të zhvillimit ekonomik dhe punësimit të përgjithshëm në Shqipëri.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme luajnë rol të madh në zhvillimin ekonomik dhe social, por edhe janë mjaft të rëndësishme, për shkak të kontributit në funksionimin e rrjetit ekonomik dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Këto kontribute janë shumë të rëndësishme në kushtet kur niveli i papunësisë vazhdon të mbetet i lartë.

Sidomos në vende si Shqipëria, zhvillimi i NVM-ve kontribuon në përballimin e çështjeve të shumta të lidhura me zhvillimin ekonomik, me efektet e pabarazisë sociale, me nivelin e lartë të papunësisë, me rritjen më të shpejtë demografike dhe me nevojën shumë të madhe për ndryshime strukturale në përgjithësi.

Zhvillimi i NVM-ve ofron mundësi të mëdha punësimi, të cilat do të ndihmojnë në zvogëlimin e nivelit të papunësisë, dhe në përballimin e problemeve demografike të popullatës, të cilat janë në rritje mjaft të shpejtë.

Zhvillimi i NVM-ve gjithashtu kontribuon në forcimin e konkurrencës dhe të prodhimërisë, duke nxitur edhe rritjen e të ardhurave globale dhe të ardhurave për frymë në Shqipëri.

Për shumë njerëz zotërimi i biznesit të vogël, për shkak të pavarësisë së madhe dhe të ardhurave financiar që sjell, është tepër joshës dhe kjo bën të mundur dhe i bën faktorë NVM-të që të jenë burim i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Projekti i titulluar "Krijimi i një platforme me njohuritë e nevojshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në treg" me akronimin Skills4MSEs zbatohet në kuadër të programit "Programi i Bashkëpunimit Ballkanik - Mesdhetar 2014 - 2020"

Ky Projekt bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse.



Roli i Fondit Besa në financimin e biznesit të vogël dhe impakti që ka tek klientela është

një nga temat që u trajtua gjatë takimit nga Z. Gentian Muça.

Ai thekson se Fondi Besa aktualisht është një ndër institucionet në mbështetje të sipërmarrjes mikro, të vogël dhe të mesme në Shqipëri me një shtrirje të aktivitetit në të gjithë Shqipërinë. Për ne si institucion – shton Z. Gentian është shumë e rëndësishme të kemi klientë që dinë të menaxhojnë mirë biznesin e tyre, që janë të aftë profesionalisht dhe gjithashtu zotërojnë aftësi të mira komunikimi, marketingu, etj, aftësi që të kombinuara sëbashku sigurojnë suksesin e biznesit të tyre, dhe nga ana tjetër rritjen e fitimit cka bën të sigurtë kthimin e kredisë.

Sigurisht Fondi Besa ka objektiva ambicioze financiare, por edhe sociale, të cilat i realizon ditw pas dite nw aktivitetin e tij, tw shtrirw nw rreth 80 zyra dhe 32,400 klientw me njw portofol kredie prej 13.1 miliardë lekë.

